



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

**KOMISIONI PËR BUJQËSI, PYLLTARI, ZHVILLIM RURAL,
MJEDIS DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR**

**Legjislatura e –III-
Mbledhja nr. 2-2008
Prishtinë, më 14.2.2008, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10**

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Lulzim Zeneli, Zylfi Merxha, Berat Luzha, Elheme Hetemi, Ali Lajçi, Zef Morina, Haset Cakolli, Selvie Halimi dhe Myrvete Pantina.

Munguan: Ibrahim Selmanaj dhe Kosara Nikolić

Nga zyra e komisioneve të Kuvendit : Ahtere Loxha dhe Bajram Badivuku

Pjesëmarrsit tjerë: Monitoruesi nga presidenca.

Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komisionit Lulzim Zeneli

Kryetari hapi mbledhjen dhe propozoi këtë;

Rend Dite

1. **Miratimi i rendit të ditës**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**
3. **Shqyrtimi i kërkesës së Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina dhe kërkesës së Agjencionit Pyjor të Kosovës**

1.Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2.Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i kërkesës së Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina dhe kërkesës së Agjencionit Pyjor të Kosovës.

Kryetari theksoi se lidhur me këto 2 kërkesa në mbledhjen e kaluar ishte formuar një grup punues në përbërje prej **Ibrahim Selmanaj, Selvije Halimi, Kosara Nikoliq dhe Elheme Hetemi**, grupi punues kishte shqyrtuar kërkesat dhe për komisionin kishin pregaditur sugjerimet me shkrim të cilat i kanë marrë të gjithë anëtarët.

Në vazhdim **Kryetari** hapi diskutimin.

Elheme Hetemi anëtare e grupit punues,lidhur me kërkesën e pare të Agjencionit të pyjeve në të cilën kërkojnë mjete financiare shtesë në vlerë prej 600.000 euro për ripyllëzimin e 500 hektarëve në zonat e dëmtuara nga zjarret gjatë vitit 2007, ajo tha se pasi që aprovimi i buxhetit po bëhet për një kohë shumë të shkurtë dhe nuk ka kohë për tu alokuar ato mjete për ndarje, grupi punues sugjeron që komisioni ynë ta shqyrtoj këtë kërkesë në gjashtëmujorin e dytë gjatë rishikimit të buxhetit për vitin 2008 dhe komisioni për buxhet tani ta kaloj ashtu si është, por ta ketë parasysh gjatë rishikimit të buxhetit.

Kurse sa i përket kërkesës së Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina ,tha se grupi punues kishte vlerësuar se duhet diskutuar më ta më gjerësisht dhe më detajishtë, për të cilën do të shqyrtoheshin çështjet ligjore dhe procedurale për shfrytëzimin e buxhetit, sepse ata kërkojnë të dalin si agjencion me vetë financim dhe tani koha është shumë e shkurtër për të dhënë komisioni ndonjë rekomandim.

Kryetari pajtohet me sugjerimin e grupit punues që kërkesa e Agjencionit pyjor të mirët parasysh dhe të shqyrtohet gjatë rishikimit të buxhetit.

Kurse lidhur me kërkesën e Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina, vlerësoj se ajo çështje do të rregullohet në përputhshmëri me ligjet në fuqi dhe të cilat janë të aplikueshme dhe mendon se më tepër kompetent për këtë çështje është komisioni për buxhet dhe komisioni për legjislacion.

Berat Luzha në parim pajtohet me sugjerimet e grupit punues dhe njoftoj se kërkesa e Agjencionit të pyjeve është hartuar në shtator të vitit të kaluar dhe mendon se janë përfshirë në buxhet, sepse një pjesë e mjeteve janë dedikuar për pyllëzime andaj tha se ka diçka në këtë drejtim.

Pasi që kërkesa nuk i është adresuar këtij komisioni, konsideroj se nuk e obligon komisionin të përgjigjet.

Heset Cakolli e përkrah në parim sugjerimin e grupit punues lidhur me kërkesën e parë dhe tha se e përkrah si ide dhe projekt kërkesën e prezentuar si dhe shumë e kërkuar, sepse tha se Kosova ka nevojë edhe më tepër se mjetet e kërkuara për ripyllëzim, por tha se në raportin e formuar nga një komision për vlerësimin e dëmeve del se janë diku mbi 600 hektar të djegura, 200 në sektorin privat kurse 400 e diçka hektar në sektorin shoqëror dhe vlerësoi se si komision pa e pas një projekt nuk e dimë se a arsyetohet shuma e kërkuar, si dhe a janë të destinuara për sektorin publik apo privat.

Në fund tha se kështu në këtë formë nuk mundemi të japim asnjë rekomandim lidhur me këtë çështje.

Andaj konsideroj se në të ardhmën kur arrijnë kërkesat e tilla së bashku me kërkesën do duhej me pas edhe ndonjë projekt .

Kurse lidhur me kërkesën e dytë përkrah sugjerimin e grupit punues ashtu si është dhënë.

Myrvete Pantina përkrah sugjerimin e grupit punues për kërkesën e parë dhe mendon se kërkesa për ndarjen e mjeteve është e drejtë por duhet shkuar me procedurë të paraparë,po ashtu për kërkesën e dytë pajtohet ,nëse ua lejon ligji të ndahen si agjencion me vetë financim .

Por vlerësoi se në buxhetin e Ministrisë së Bujqësisë shumë pak është ndarë.

Për Departamentin e pyjeve janë ndarë 20.000€ për shpenzime kapitale dhe 64.000€ për mallra dhe shërbime kurse për Agjencionin e Pyjeve vetëm 397.000€ dhe mendon se këto mjete nuk janë të mjaftueshme.

Elheme Hetemi u ndërlihdh në diskutim dhe tha se shumë organizata ndërkombëtare kanë kontribuar dhe financuar në mbrojtjen e ambientit, UNDP është financuese e madhe në mbrojtjen e ambientit konkretisht edhe në pyllëzim . Agjencioni për pyje është një agjencion shërbyes që nuk vetëfinancohet dhe ata marrin fonde prej organizatave ndërkombëtare. Nga Qeveria shumë pak kanë përfituar dhe pas gjashtëmujorit do duhej të bëhet një analizë më e madhe si legjislative dhe ekzekutive dhe të shohim ku janë ngecjet dhe të shikojmë se a mundet me u bërë ndarje pikërisht për këtë çështje .

Myrvete Pantina njoftoi komisionin që gjatë shqyrtimit të buxhetit për vitin 2008 nga komisioni për buxhet ku ishte anëtare, ishte debatuar për ndarjen e mjeteve nëpër ministri të ndryshme. Ajo kishte propozuar që Ministrisë së Bujqësisë ti ndahen mjete për subvencione, sepse konsideron se nevoja për subvencionimin e bujqve është shumë e madhe. Propozimin e saj tha se e kishin përkrah shumica e deputetëve , mirëpo kryetari i komisionit për buxhet kishte thënë se për me u shqyrtua ky propozim, kërkesa duhet të bëhet nga komisioni për bujqësi, por pasi koha është shumë e shkurt që tani të bëhet kërkesa, propozoj që në gjashtëmujor gjatë rishikimit

të buxhetit gjithsesi të bëhet kërkesa nga ana e komisionit, andaj edhe kërkoj që ky propozim të përkrahet nga anëtarët e komisionit .

Elheme Hetemi konsideroj se subvencionimi është temë e gjerë ku duhet me diskutua dhe debatuar më gjer, për me dalë me ndonjë rekomandim.

Berat Luzha njoftoj anëtarët se vitin e kaluar ky komision i kishte bërë kërkesë MEF për subvencionimin e bujqve , ajo nuk është marrë si e tillë, por është shtuar buxheti i Ministrisë së bujqësisë.

Për subvencione ai tha se duhet formuar një fond i posaçëm dhe në Ligjin për Menaxhimin e financave publike nuk parashihet formimi i asnjë fondi për subvencione.

Kryetari theksoi se kërkesat që na vijnë në komision nga 2 ministrat, ne do ti shqyrtojmë në vazhdimësi, do të zhvillojmë takime do ti shikojmë problemet e tyre dhe në 6 mujor do të kemi mundësi të i bëjmë kërkesë MEF për ndarje të mjeteve.

Kërkoj nga anëtarët nëse nuk ka ndonjë vërejtje substanciale të miratohet sugjerimi i grupit punues.

Kryetari konstatoj se njëzëri u miratua sugjerimi i grupit punues dhe u nxorr ky:

Përfundim

1. Lidhur me kërkesën e Agjensionit Pyjor të Kosovës (APK), për mundësin e lejimit të mjeteve financiare në vlerë prej 600.000 euro për pyllëzimin e 500 ha në zonat e dëmtuara nga zjarret gjatë vitit 2007 .

Komisioni konsideroj se në pamundësi të sigurimit të mjeteve në fillim të vitit buxhetor ,kjo çështje të mirët parasysh dhe të shqyrtohet pas 6 mujorit, në kohën e rishikimit buxhetor për vitin 2008.

2. . Kurse lidhur me kërkesën e Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) do të rregullohet në përputhshmëri me ligjet në fuqi.

Takimi përfundoi në orën 12,45

Procesverbalin e hartoj

Ahtere Loxha

Kryetari i Komisionit

Lulzim Zeneli,

